



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TROPOJE
KESHILLI BASHKIAK

Nr 351/1 Prot

B.Curri, me 07 . 03 . 2022

V E N D I M

Nr 20 Dt .28.02. 2022

PËR

MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË TROPOJË, SË BASHKU ME DOKUMENTACIONIN TEKNIKO LIGJOR PËR AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE PËR FAMILJET BANESAT E TË CILEVE JU ËSHTË DËMTUAR ÇATIA NGA MOTI I KEQ DHE FURTUNA JANAR 2022.

Këshilli i Bashkisë Tropojë, në mbledhjen e tij të datës . 2022, në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1/1.1, shkronja “b”, nenit 34 pika 6, nenit 54 shkronja “dh” dhe nenit 55 pika 3 dhe 6 të Ligjit Nr.139/2015 “Per Vetqeverisjen Vendore”; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; ligjit nr. 45/2019, “Per Mbrojtjen Civile”, Kreu III, pika 1 germa “ë”, pika 2, pika 3 gërmat “ç”, “e”, “ë” të VKM-së nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmëve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 263, datë 24.05.2013 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve ndërtimore të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”; Sipas kërkesave të bëra nga pronarët e objekteve , njëkohësisht duke parë gjëndjen e rënduar ekonomike të kësaj familje, për ti përballuar këto dëmtime të Banesës.

V E N D O S I :

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Tropojë për përgaditjen e dokumentacionit për dhënie ndihme financiare, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga Moti i keq dhe furtuna e muajit Janar. Emrat e të cilëve janë paraqitur më poshtë:

- Familjes se Z , **AZEM SHABAN KURBALAJ**, fshati Bucaj , Njësia Administrative Tropojë , bashkia Tropojë , ti jepet një ndihmë e menjëhershme leke **100 000** (njëqind mijë).
- a) Vlera sipas VKM-së nr. 329 Kreu III, pika 3 germa ”b’ dhe “d“ është **126 682 leke**, (njëqind e njëzet e gjashtë e mijë e gjashtëqind e tetëdhjet e tre). Për shkak të

pamundesisë së financimit nga Bashkia Tropoje, për të mbuluar të gjithë vleren në lekë i jepet shuma **100 000** (njëqind mijë) lekë.

b) Në një moment të dytë, pasi të sigurohet fondi do të bëhet likuidimi i plotë i pjesës së mbetur **26 682**

➤ Familjes se Z , **KOLË NIKË MACAJ**, fshati Rajë , Njësia Administrative Firzë , bashkia Tropojë , ti jepet një ndihmë e menjëhershme leke **100 000** (njëqind mijë).

a) Vlera sipas VKM-së nr. 329 Kreu III, pika 3 gërma "b" dhe "d" është **121 385 leke**, (njëqind e njëzet e një mijë e treqind e tetëdhjet e pesë). Për shkak të pamundesisë së financimit nga Bashkia Tropoje, për të mbuluar të gjithë vleren në lekë i jepet shuma **100 000** (njëqind mijë) lekë.

b) Në një moment të dytë, pasi të sigurohet fondi do të bëhet likuidimi i plotë i pjesës së mbetur **21 385**

2. Burimi i financimit është Fondi Emergjences Civile të parashikuar në buxhetin e Bashkisë Tropojë për vitin 2022 miratuar me VKB , Nr.111 datë 24.12.2021, "Për miratimin e buxhetit dhe numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë Tropojë për vitin 2022."

3. Të miratojë dokumentacionin tekniko- ligjor të hartuar nga Bashkia Tropojë

4. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohen Sektori i Emergjencave Civile, Drejtoria Ekonomike, Sektori i Finances.

5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretar
Ergent GJONGECAJ

Kryetar
Shotë BASHAJ



Shpallur me 07.03.2022
Miratuar me 14 vota
Vota Pro 13
Vota Kunder 0
Vota Abstenim 1